



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 2
Prishtinë, më 23 mars 2011, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Bali Muharremaj, Muhamet Mustafa dhe Albert Kinolli.

I ftuar: z. Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, Musa Rudaku – zyrtar i fushës së ekonomisë dhe i financave, KIPRED (staf mbështetës) - Artan Venhari e Albert Krasniqi dhe Arta Demolli – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i kërkesës Buxhetore të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011,
3. Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për emërimin e auditorit të jashtëm, për auditim të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2010,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi propozoi që në rend dite të përfshihet edhe procesverbali i mbledhjes së datës 21 mars 2011, meqenëse është i gatshëm për shqyrtim.

Rendi i ditës u miratua me propozimin e kryesuesit të Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21 mars 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 21 mars 2011.

3. Shqyrtimi i kërkesës Buxhetore të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011

Kryesuesi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se për shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, i ftuar është edhe z. Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm.

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm – Dha arsyetimin pse kërkesa buxhetore e ZAP- it është më e ulët krahasuar me projekt-buxhetin e propozuar nga Qeveria. Ai tha se ne kemi dërguar kërkesën buxhetore në muajin tetor. Ky buxhet është ndërtuar në bazë të marrëveshjes që e ka Kosova me Bashkimin Evropian, në kuadër të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian, sipas të cilës kjo organizatë për të kompensuar numrin e stafit ndërkombëtar, që do të largohet me staf vendor, numri i të punësuarve çdo vit duhet të rritet për 20 %, gjatë një periudhe pesëvjeçare. Qeveria e kaluar dhe Auditori i Përgjithshëm ka pasur një marrëveshje që Qeveria nuk duhet ta prekë kërkesën buxhetore të ZAP- it. Qeveria e re e ka bërë këtë dhe kjo ka ndodhur në baza të një gabimi teknik. Në Kuvend është dukur se është paraparë buxhet më i madh për ZAP- in, se sa që është kërkuar. Dhe kjo ka ndodhur pasi që është llogaritur edhe 30 % rritje në paga, sipas vendimit të Qeverisë.

Kryesuesi – Është një gabim teknik për shkak të kohës kur janë përpunuar të dhënat. Vendimi për rritje të pagave ka ndodhur më vonë. Komisioni për Buxhet është ai që përgatit raportin për Kuvend, ndërsa KMFP vetëm bënë rekomandim për Komisionin për Buxhet dhe Financa. E hapi diskutimin.

Ramiz Lladrovci - Nga kërkesa e ZAP- it shihet se është llogaritur kostoja e pagave dhe e mëditjeve rreth 1.2 milionë euro. ZAP- i ka bërë edhe një kërkesë për rritjen e koeficientit për punëtorët. Përkrah kërkesën buxhetore të ZAP- it, por meqenëse është paraparë rritja e pagave, koeficienti duhet të mbetet i njëjtë, si ka qenë.

Mursel Haljilji – Në vitin 2010 ishin 116 të punësuar dhe sipas planit për vitin 2012 dhe 2013 ZAP- i planifikon që numri i të punësuarve të arrijë në 147 punëtorë. Sipas cilave kritere është bërë ky vlerësim, që numri i të punësuarve të jetë kështu? Pasi që buxheti po ndryshon sipas numrit të të punësuarve, a është e nevojshme që në këtë vit të punësohen 14 veta, apo duhet për tri vitet e ardhshme të ndahen mjetet sipas planit?

Valbona Dibra – Nuk u pajtua lidhur me “gabimin teknik të Qeverisë” që ju referua z. Lage, për faktin se format që janë para deputetëve, të llogaritura sipas kërkesave të Zyrës, kanë qenë formularë të dedikuar dhe kufijtë e Qeverisë kanë qenë deri në këtë masë. Sipas të dhënave numri i punëtorëve në të gjitha vitet është i njëjtë. Qeveria ka kërkuar që të jetë kjo formë e formularit dhe të sqarohet me një dokument shtesë rritja e numrit të punëtorëve për secilin vit, edhe për paga. Kjo ka qenë pengesa që në kërkesë buxhetore nuk është reflektuar edhe rritja e numrit të punëtorëve. Përkrah rritjen e numrit të punëtorëve, kjo si domosdoshmëri që kjo zyre të këtë staf për të mbuluar gjithë territorin e Kosovës me auditime.

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm – Na nevojiten më shumë udhëheqës të ekipeve, më shumë drejtorë për të mbuluar fusha të ndryshme. Dhe sigurisht kur personat bëhen udhëheqës, ata automatikisht ngritën edhe në nivelin e strukturës sa i përket koeficienteve. Kjo vjen nga Ministria e Administratës Publike dhe auditori i përgjithshëm nuk ka autoritet ta ndryshoj këtë. Kur auditorët kalojnë provimet profesionale, ata automatikisht lëvizin në këtë shkallë të koeficienteve. Sa i përket kritereve kjo bazohet në marrëveshjen që ka Kosova me BE-në. ZAP-i është institucion i pavarur dhe kufizimet që i ka bërë Qeveria nuk i përshtaten, por kjo është një çështje për t’u zhvilluar.

Ramiz Lladrovci – Tha se rritja e koeficienteve e rrit bazën e pagave për 160 mijë euro, për 116 anëtarë të stafit, duke i shtuar kësaj edhe 14 persona dhe kjo kosto shkon mbi 200 mijë euro. Ne

jemi në një situatë të jashtëzakonshme. Rritja e pagave, pastaj shtesat, ngritja e koeficientit po e rrisin koston e buxhetit në mënyrë të pa arsyeshme dhe kjo është për t'u brengosur.

Bali Muharremi- Pyeti sa është mesatarja e pagave në ZAP? Problemi i buxhetit është i ditur dhe nëse shkohet me rritje 30% të pagave, atëherë s'ka nevojë për rritje të koeficientit.

Valbona Dibra - Pyeti për sa punëtorë është paraparë rritja e koeficientit?

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm - Koeficientet nuk ndryshojnë. ZAP- i nuk po ndryshon nivelin e koeficienteve, kjo po bëhet nga Qeveria. Kjo organizatë për të mbuluar rreth 100 auditime, në vend të 23 auditimeve që kanë qenë më përpara, duhet të organizojë punën më ndryshe dhe për të mbuluar këto punë, numri i drejtorëve dhe udhëheqësve të ekipeve do të rritet.

Ali Sadriu: Pyeti: sa pozita të tilla keni?

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm - Sa i përket pagës mesatare në ZAP, pra ishim 116 dhe nëse e pjesëton në shumën e vitit të kaluar, që është shpenzuar në total për paga dhe mëditje, atëherë del paga mesatare, dhe aty përfshihet edhe 5 % i kontributeve të pensionit.

Bali Muharremaj – Tha se paga e një auditorit, është shumë më e madhe se e një kryetari të komunës, është sa dy herë e një drejtori të departamentit dhe për këtë arsye jam i mendimit që meqenëse është shkuar me rritje 30% të pagës, të mos shkohet edhe me 5 % koeficient.

Armend Zamaj – Shprehu keqardhje që përsëri vazhdohet me të njëjtat probleme. Qeverisë së Kosovës, i konvenon që ZAP- i të jetë më i dobët në këtë drejtim. Kjo po ndodh përmes shkurtimeve buxhetore.

Sipas raporteve ZAP- it në përgjithësi çdo organizatë buxhetore ka qenë në rregull, ndërsa raportet e policisë flasin për krime ekonomike dhe të tjera. Në këtë drejtim Auditori i Përgjithshëm është dashur të marrë parasysh edhe performancën që ka ndodhur në vitin 2010 dhe të ketë arsye të fortë para këtij komisioni dhe komisioneve të tjera, kërkesën për rritje të koeficienteve dhe rritje të pagave. Përkrah kërkesën buxhetore të ZAP- it, por duhet kërkuar edhe përgjegjësi se sa zbatohet në praktikë edhe performanca e punës edhe e raporteve të auditimit që ZAP i bënë organizatave buxhetore.

Valbona Dibra – ZAP është institucion i pavarur dhe është apolitik, kështu që duhet besuar në profesionalizmin e auditorëve, sepse asnjë auditor nuk do të rrezikonte punën e tij për të mbrojtur një institucion, në rastin konkret një ministri ose një komunë, për shkak të Qeverisë.

Armend Zemaj – Tha se ka qenë protagonist kryesor që ka kërkuar rritje të pagave për ZAP- in dhe për pavarësi të plotë të tij, por duhet të kërkuar edhe përgjegjësi në punën e tyre.

Ali Sadriu – Ndau mendimin me shumë kolegë që ky institucion duhet të jetë profesionalisht në nivelin më të lartë dhe në këtë drejtim në një takim të ardhshëm do të diskutohet me Auditorin e Përgjithshëm edhe rreth performancave. Kosova ka nevojë për një institucion të tillë, të fuqishëm, profesional edhe të pavarur. A është në nivelin e duhur, është çështje tjetër, por duhet ta kuptojmë që është në fazën fillestare dhe duhet të avancohet. Propozoi që kërkesa buxhetore të përkrahet.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike me **nëntë vota për** dhe **asnjë kundër**, ka vendosur që Komisionit për Buxhet dhe Financa t'i:

REKOMANDOJ

Të miratohet kërkesa buxhetore e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për emërimin e auditorit të jashtëm, për auditim të pasqyrave vjetore financiare për vitin 2010

Kryesuesi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se në bazë të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bashkërendim me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike të ndërmarrë aktivitetet për shpalljen e njoftimit për kontratë për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm, për auditim të pasqyrave vjetore financiare të ZAP- it, për vitin 2010. Pas hapjes së ofertave, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e formon komisionin vlerësues për vlerësimin e ofertave nga radhët e deputetëve anëtarë të Komisionit. E hap diskutimin.

Valbona Dibra – Pyeti se kush përcakton kriteret për shpallje të njoftimit për kontratë?

Ramiz Lladrovci – Propozoi që të autorizohet kryetari i Komisionit, që në afatin ligjor të merret me këtë çështje, të formoj komisionin vlerësues për vlerësimin e ofertave.

Armend Zemaj – Tha se kjo është çështje më tepër procedurale e Divizionit të Prokurimit dhe propozoi që kryesia e ngushtë e Komisionit, si dhe ndonjëri nga anëtarët të autorizohet për këtë çështje.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike me **nëntë vota për dhe asnjë kundër** nxori këtë

Përfundim

1. *Kërkohet nga Administrata e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që në bazë të Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr 04-P-004/k, më 15 mars 2011, t'i kryej të gjitha aktivitetet administrative teknike për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të ZAP- it, për vitin 2010.*
2. *Autorizohet kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike që pas hapjes së ofertave ta formojë Komisionin Vlerësues prej tre anëtarëve për vlerësimin e ofertave.*
3. *Raporti i Komisionit Vlerësues i paraqitet Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për shqyrtim, dhe procedim të mëtejshëm.*

5. Të ndryshme

a) Plani i Punës së Komisionit

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, me **nëntë vota për asnjë kundër** nxori këtë

Vendim

Me Planin e Punës të Komisionit merret kryetari dhe dy zëvendëskryetarët e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu